



Testi i garave komunale nga lënda e Gjeografisë për klasën e VII (të shtatë).

1. Në cilin vendkalim kufitar të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë pikat kufitare të rëndësishme Bllacë dhe Tabanovcë?

Kufiri verior

2. Sipas relievit çfarë territori është territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut?

Kryesisht malore

3. Në cilin grup malesh dhe luginash ndodhet mali Pllaçkovica?

Grupi Lindor i Vardarit

4. Cilat nga malet e mëposhtme gjenden në Maqedoninë e ulët ose në Povardarje?

Mali i Zi i Shkupit dhe Kozhufi

5. Cila luginë gjendet në rajonin e maleve të Sharrit?

Lugina e Dibrës-Rekës

6. Pellgu i cilit prej lumenjve të mëposhtëm ndodhet në rajonin e Pellagonisë?

Markova Reka dhe Topollka

7. Në cilin grup malesh dhe luginash lumenjtë Radika dhe Sateska janë objekte hidrografike më të rëndësishme?

Rajoni i maleve dhe luginave të Sharrit

8. Në cilën zonë termike ndodhet territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut?

Brezi i zonës mesatare veriore

9. Përgjatë luginave të cilit lumenjëve, cila është klima më e ndikuar nga deti Egje?

Vardari dhe Strumica

10. Cili det ndikon në klimën përgjatë luginës së lumit Drini i Zi?

Deti Adriatik

11. Çfarë ndikimi klimatik ndihet nga veriu dhe lindja në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut?

Ndikimi kontinental

12. Me çfarë klime karakterizohen lugina e Kërçovës dhe e Kumanovës?

Klimë tipike kontinentale

13. Cila luginë karakterizohet nga kalimi i klimës mesdhetare në atë kontinentale?

Lugina e Strumicës-Radovishit

14. Në cilin drejtim fryn era e jugo?

jug-veri

15. Cila erë në Republikën e Maqedonisë së Veriut fryn në pjesën dimërore të vitit në drejtim veri-jug, përgjatë luginës së Vardarit?

Vardareci

16. Në cilën periudhë të vitit ka më së shumti reshje në Republikën e Maqedonisë së Veriut?

dimrit dhe vjeshtës

17. Cilat zona në Republikën e Maqedonisë së Veriut karakterizohen me rreth 500mm/m² reshje në vit?

Ovçepole dhe lugina Tikveshit

18. Sa është sasia vjetore e reshjeve në vargmalin e Korabit dhe në malin Bistra?

mbi 1000 mm/m²

19. Cili nga llojet e mëposhtme klimatike nuk është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut?

Lloji i klimës subtropikale

20. Cili lloj tipi klimatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut karakterizohet me verë të ngrohtë dhe të thatë, dimër të butë dhe me shi, vjeshtë më të gjatë dhe më të ngrohtë dhe pranverë më të shkurtër dhe më të freskët?

Lloji i klimës së modifikuar-mesdhetare

21. Përgjatë cilave lugina lumore ndihet ndikimi i klimës mesdhetare, deri në Luginën e Ohrit-Strugës dhe fushëgropën e Koçanit?

Lumenjtë Drini i Zi dhe Bregalnica

22. Cili tip klimatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut karakterizohet me verë mesatarisht të ngrohtë dhe të thatë dhe me dimër mesatarisht të lagësht dhe të ftohtë?

Iloji i klimës së butë kontinentale

23. Çfarë lloji tipi klimatik është karakteristik për luginën e Pollogut, Pellagonisë dhe Prespës?

Iloji i klimës së butë kontinentale

24. Cili lloj tipi klimatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut karakterizohet me dimër të gjatë, të ftohtë dhe me shi dhe me verë më të shkurtër e të freskët?

Iloji i klimës malore

25. Në cilin pellg lumor janë lumenjtë Vardar dhe Strumicës janë lumenjtë kryesorë?

Pellgu i lumor i Detit Egje

26. Cilët nga lumenjtë e mëposhtëm janë degët e djathta të lumit Vardar?

Treska, Topollka dhe Babuna

27. Cilët nga lumenjtë e mëposhtëm janë degë të majta të lumit Vardar?

Pena, Lepeneci dhe Pçinja

28. Në cilin lum, në Grykën e Istibanjit, është ndërtuar akumulacioni(liqeni) i Kalimancit?

Lumi Bregallnicë

29. Cili lum buron në afërsi të fshatit Zheleznec të rajonit të Demirhisarit dhe është i gjatë 207 km?

Cërna Reka

30. Cilët dy akumulacione(liqene) janë ndërtuar në lumin Treska?

Liqenet e Matkës dhe Kozjakut

31. Cilit pellg lumor i përket ujërat që dalin nga liqeni i Ohrit?

Pellgu i lumor i Detit Adriatik

32. Cili nga grupet e lumenjve të mëposhtëm përmban një lumë që nuk i përket pellgut lumor të Egjeut?

Treska, Lumi Kadina, Topollka, Radika

33. Cili liqen në Republikën e Maqedonisë së Veriut ndodhet ndërmjet malit Galicica në lindje dhe malit Mokra në perëndim?

Liqeni i Ohrit

34. Cili liqen në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjendet në lartësinë 853 metra mbidetare dhe shtrihet me sipërfaqe prej 275 km²?

Liqeni i Prespës

35. Si ndahen liqenet natyrore në Republikën e Maqedonisë së Veriut?

Tektonike dhe akullnajore(glaciale)

36. Sa sipërfaqe zë liqeni i Dojranit?

43 km²

37. Çfarë lloj liqenesh, sipas origjinës së tyre, janë Liqenet e Vogla dhe të Mëdha në malin Baba?

akullnajore

38. Nga cili liqen derdhet uji nën tokë në liqenin e Ohrit?

Liqeni i Prespës

39. Cili lum buron rrëzë malit Stogovë afër fshatit Izvor?

Treska

40. Në cilin mal ndodhen liqenet akullnajore Bogovinjsë dhe Liqenit të Zi?

Mali Sharr

